

Udhëzues për rihapjen e parashkollorit dhe kopshteve pas COVID-19

UNICEF për Evropën dhe Azinë Qendrore

22 maj 2020

HISTORIKU

UNICEF-i është angazhuar në mënyrë shumë aktive me qeveritë, me qëllim mbështetjen e përpjekjeve të tyre për të vlerësuar dhe për të vendosur mbi kohën dhe mënyrën e rihapjes së institucioneve parashkollore dhe kopshteve. Vendimi për ta rihapur pjesërisht ose plotësisht parashkollorin duhet të ndjekë një qasje me bazë rrezikun, me qëllim maksimizimin e përparësive arsimore, zhvillimore dhe shëndetësore të fëmijëve, mësuesve, stafit dhe komunitetit të gjerë, si dhe dhënien e ndihmesës për të parandaluar valën e dytë të epidemisë së COVID-19 në komunitetⁱ. Në kuadrin e rihapjes së shkollave, UNICEF-i dhe partnerët e tij nënvizojnë gjashtë dimensionet kyçe, që duhen marrë parasysh: *politikat, financimi, veprimtaritë e sigurta, të nxënies, mbulimi i personave më të marginalizuar, dhe mirëqenia/mbrojtja*.ⁱⁱ Së fundmi, OBSH-ja ka botuar udhëzime që përmbajnë konsiderata të dobishme për rihapjen e shkollave në përgjithësi, mbështetur në vlerësimin e kujdesshëm të rrezikut të faktorëve epidemiologjikë dhe kapacitetit të sistemit shëndetësor, ndër të tjera.ⁱⁱⁱ

Parashkollori dhe qendrat e zhvillimit në fëmijërinë e hershme (ZHFH) ndjekin një qasje arsimore unike dhe janë ndër institucionet e para që po mendohet të rihapen. Në shumë vende mësimi cilësor në distancë për nxënësit e parashkollorit, veçanërisht për grupet e marginalizuara nuk ka qenë i mundur, ndaj, qeveritë do të vendosin të rihapin kopshtet përpara shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe të zgjasin mësimin në internet për nxënësit më të mëdhenj. Duke mbajtur parasysh rolin e parashkollorit në mbështetjen e fëmijëve, ashtu edhe në kthimin e prindërve në punë, zbutja e masave të izolimit nënkupton se me kthimin e prindërve në punë, fëmijët e vegjël do të kenë nevojë të ngutshme për kujdes.

Ndonëse mbështetet mbi udhëzuesit e mëparshëm, ky udhëzues është hartuar enkas për parashkollorin dhe kopshtet, pasi organizimi dhe qasja e tyre pedagogjike kanë natyrë unike që përqendrohen te fëmijët e vegjël, kujdesi mëkues, dhe të nxënies. Udhëzimi përvijon parimet kyçe gjithëpërfshirëse dhe masat praktike, që duhen marrë në konsideratë për rihapjen e parashkollorit dhe kopshteve, sidomos për fëmijët mbi moshën 3-vjeçare^{iv}.

PARIMET ORIENTUESE PËR RIHAPJEN E PARASHKOLLORIT DHE KOPSHTEVE

Vendimmarrësit mund të përdorin një sërë parimesh gjithëpërfshirëse orientuese në planifikimin dhe zbatimin e rihapjes së parashkollorit dhe kopshteve. Këto parime bazohen mbi nevojën për të gjetur ekuilibrin ndërmjet mbështetjes së efektshme të të nxënies dhe mirëqenies së fëmijëve të vegjël, duke garantuar shëndetin, higjienën, dhe sigurinë e fëmijëve, stafit, komunitetit, në përgjithësi.

- 1. Shpenzoni kohë për të planifikuar dhe për t'u përgatitur për rihapjen e parashkollorit.** Mos u nxitoni për ta rihapur parashkollorin pa pasur një plan të qartë mbi aspekte të ndryshme se si do ta trajtoni këtë proces, duke përfshirë planifikimin e të nxënies, turnet, protokollet e higjienës, etj. Qasja më e efektshme do të ishte *qasja në mbarë parashkollorin*, duke përfshirë komunikimin dhe mbështetjen e kujdestarëve, mësuesve, administratës së shkollës, komunitetit, dhe qeverisë vendore. Trajnimi i edukatorëve përpara rihapjes lidhur me pritshmëritë ndaj tyre dhe zbatimin e

kurrikulës së përshtatur, si dhe komunikimi i qartë me prindërit, janë ndër elementet kyçe që duhen marrë parasysh.

- 2. Mos e teproni me mbrojtjen e fëmijëve** Veprimet për sigurinë e fëmijëve janë thelbësore, por mjediset e parashkollorit nuk duhet të duken si spitale. Muajt e fundit kanë qenë shqetësues për fëmijët (rutina e të cilëve ka ndryshuar, informacionet kanë qenë çorientuese, etj.). Tani më shumë se kurrë, fëmijët kanë nevojë për mjedise të sigurta, argëtuese dhe stimuluese. Për këtë arsye, rihapja e parashkollorit/kopshteve, përfshin kthimin e fëmijëve në normalitet dhe në rutinë, njëkohësisht duke garantuar mbrojtje të arsyeshme në mjedisin ku luajnë dhe mësojnë.
- 3. Sigurohuni që institucionet parashkollore mund të vijojnë zbatimin e praktikave të përshtatshme për fëmijët dhe zhvillimin e tyre** Distanca e sigurt midis fëmijëve nuk duhet të ndikojë tek angazhimi social, mësimi praktik, dhe lojërat që promovojnë të gjitha fushat e zhvillimit. Ndonëse shumë aspekte të botës sonë kanë ndryshuar, kjo gjë nuk ka ndodhur me fëmijët e vegjël. Në kontekstin e distancimit fizik, duhet hartuar një plan i qartë për të ofruar aktivitete edukuese dhe lojëra me në fokus fëmijën. Për të gjitha këto nevojitet përshtatja e kurrikulës dhe praktikave të mësuesve, duke qenë në përputhje me parimet zhvillimore.
- 4. Përdorni praktika dhe sjellje të shëndetshme të higjienës** (duke përfshirë larjen e duarve, mbulimin e gojës gjatë kollitjes dhe teshtitjes, mosprekjen e fytyrës) për fëmijët e vegjël (kjo aftësi zgjat gjithë jetën). Në kurrikul ndërthurni informacione të përshtatshme për moshën në lidhje me virusin, dhe mbështetini fëmijët me praktikat e mira të higjienës përmes rutinës ditore; tregoni teknikat e efektshme të larjes së duarve; si dhe caktoni orare gjatë ditës kur fëmijët mund t'i praktikojnë këto sjellje.
- 5. Shfrytëzoni rastet kur mund t'iu mësoni** fëmijëve përse në mjedisin e tyre janë marrë disa masa të caktuara, dhe çfarë roli luajnë ato në garantimin e shëndetit të vetë atyre, por edhe të bashkëmoshatarëve, mësuesve, familjeve, dhe komuniteteve të tyre. Shpjegojuni fëmijëve përse disa lodra janë hequr, përse dritaret hapen shpesh, si dhe cilat lojëra mund të luajnë në ambient të hapur dhe përse. Gjeni mënyra për t'i ndihmuar fëmijët që të ndjejnë se kanë kontroll mbi mjedisin e tyre.
- 6. Krijoni partneritet me familjet për të garantuar një fazë të lehtë të kalimit nga izolimi në shtëpi drejt institucioneve parashkollore, si dhe mbani komunikim të hapur dhe të vazhdueshëm.** Me gjithë përpjekjet e institucioneve parashkollore për të ruajtur komunikim të hapur, marrëdhëniet midis prindërve dhe stafit kanë ndryshuar. Krahas kësaj, prindërit do të ndiejnë ankth si për sigurinë e tyre, ashtu edhe atë të fëmijëve. Komunikoni qartësisht, pozitivisht dhe haptas me prindërit dhe familjet, në mënyrë që të shmangni ndjesinë e panikut dhe të frikës të kujdestarët, të siguroni mbërritjen dhe largimin pozitiv nga institucioni, si dhe t'i mbështetni vazhdimisht fëmijët në shtëpi. Këtu përfshihet informimi i familjeve për masat mbrojtëse dhe angazhimi i tyre në mbështetjen e zbatimit të efektshëm të këtyre masave.
- 7. Jepuni përparësi trajnimit dhe mbështetjes së edukatorëve dhe stafit të parashkollorit.** Stafi dhe edukatorët do të kenë nevoja të vazhdueshme për trajnim specifik dhe mbështetje praktike për t'u kthyer në punë. Krahas kësaj, ata duhet të ekuilibrojnë respektimin e udhëzimeve shëndetësore të përshtatura dhe udhëzimeve mbi praktikat pedagogjike të përshtatshme për zhvillimin. Merrni parasysh ofrimin e mbështetjes praktike për të përshtatur aktivitetet kurrikulare dhe rutinën, zhvillimin e takimeve të rregullta midis edukatorëve për të ndarë dhe për të përpunuar përvojën e tyre, si dhe shtimin e punonjësve, sipas nevojës, për të shmangur mbingarkesën e mësuesve.

- 8. Ndiqni një qasje të bashkërenduar dhe të integruar për të garantuar përmbushjen e nevojave të gjithanshme të fëmijëve.** COVID-19 ndikon në mënyra të ndryshme mbi fëmijët e vegjël. Me kthimin e fëmijëve të cenueshëm në kopshte, mund të lindin problematika me mbrojtjen, shëndetin, ushqyerjen, dhe shëndetin mendor dhe mbështetjen psikologjike, të cilat duhet të adresohen për shkak të izolimit si pasojë e COVID-19. Sigurohuni që planet për rihapjen e parashkollorit e përfshijnë mbështetjen shtesë dhe/ose mekanizmat referues të nevojshëm, si dhe merrni parasysh nevojat specifike të familjeve dhe fëmijëve të cenueshëm, duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara.

MASAT E SUGJERUARA PËR VENDIMIN MBI RIHAPJEN E PARASHKOLLORIT DHE KOPSHTIVE

- Për të marrë vendimin mbi rihapjen (ose rihapjen e pjeseshme) të parashkollorit, merrni parasysh faktorë kyç, si:
 - Përballimi i izolimit dhe pandemisë nga institucionet parashkollore, mësuesit, stafi, prindërit dhe komunitetet;
 - Situata dhe epidemiologjia vendore e COVID-19
 - Mjediset dhe mundësia e parashkollorit/kopshtit për të mirëmbajtur masat e parandalimit dhe të kontrollit të COVID-19
 - Disponueshmëria e testeve (për të kryer survejancën dhe gjurmimin e kontakteve në komunitet); zbatimi i masave për të kufizuar përhapjen e virusit;
 - Kuptimi aktual i transmetimit dhe seriozitetit të COVID-19 te fëmijët, duke përfshirë të dhënat e reja mbi rolin që luajnë fëmijët në transmetimin e virusit.
- Anketimet me përgjigje të shpejta për prindërit dhe edukatorët e parashkollorit në veçanti mund të shërbejnë për përmirësimin e planit të rihapjes dhe mund të ofrojnë informacione kyçe, që duhen marrë parasysh, si: përqindja e kujdestarëve që duhen kthyer në punë, shqetësimet më të mëdha të kujdestarëve, përqindja e mësuesve të parashkollorit që mund të kthehen në punë, etj.
- Konsultohuni me mësuesit, stafin arsimor, dhe kujdestarët për shqetësimet dhe idetë që kanë mbi rihapjen e sigurt të shkollave. Dhënia e komenteve mbi mbajtjen parasysh të mendimeve dhe rekomandimeve të tyre.
- Analizimi i përfitimeve dhe rreziqeve sipas kontekstit mundëson prioritizimin e rihapjes së parashkollorit (ose disa institucioneve parashkollore); prioritizimin e masave për zbutjen e rrezikut në komunitetet e parashkollorit dhe të kopshteve; si dhe elementeve që diktojnë mbështetjen e mëtejshme të prindërve dhe mësuesve.
- Përgatituni për rihapjen e përshtatshme. Shmangni vendimmarrjen e shpejtë pa kaluar kohë të mjaftueshme për të përgatitur mjediset, për të përshtatur kurrikulën, nëse është e nevojshme, për të përgatitur stafin, prindërit, si dhe për të garantuar kalimin e lehtë të fëmijëve në mjedise të reja.

MASAT E SUGJERUARA PËR GARANTIMIN E VEPRIMTARIVE TË SIGURTA TË INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE^{vi}

Praktikat ditore të higjienës dhe të shëndetit në parashkollor dhe kopshte

- Caktoni pastrimin e rregullt dhe të përditshëm të klasave dhe mjediseve të parashkollorit, duke përfshirë tualetet, me ujë, sapun/detergjent dhe dezinfektantë^{vii}.
- Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet që preken shpesh, si: dorezat e dyerve, tavolinat, lodrat, mjetet, çelësat e dritave, kasat e dyerve, pajisjet për të luajtur, si dhe instrumentet e mësimi, që përdoren nga fëmijët.

- Nëse është e mundur, në parashkollor punonjësit duhet të mbajnë pajisje mbrojtëse për fytyrën. Për fëmijët e vegjël nuk rekomandohen maskat, ndërsa për fëmijët nën moshën 2-vjeçare NUK duhet të përdoren në asnjë rrethanë maska prej cope, pasi rrezikojnë mbytjen.
- Edukoni fëmijët e vegjël mbi parandalimin e COVID-19, duke përfshirë higjienën e përshtatshme dhe të shpeshtë të duarve, higjienën respiratore, si dhe simptomat e COVID-19, për të cilat fëmijët duhet të jenë në dijeni.
 - Gjeneroni një mënyrë për të monitoruar larjen e duarve dhe jepni shpërblime nëse duart lahen shpesh/në kohën e duhur (këndoni gjatë larjes së duarve për të praktikuar rekomandimin prej 20 sekondash).
 - Përdorni kukulla ose marioneta për të treguar simptomat (teshtitje, kollitje, temperaturë) çfarë të bëjnë kur nuk ndihen mirë (p.sh. iu dhemb koka ose stomaku, apo ndjejnë nxehtësi ose lodhje).
- Edukoni të gjithë stafin mbi parandalimin e COVID-19, duke përfshirë higjienën e përshtatshme dhe të shpeshtë të duarve, higjienën respiratore, përdorimin e maskave nëse kërkohen, simptomat e COVID-19 dhe çfarë të bëjnë nëse një fëmijë nuk ndihet mirë.
- Krijoni një orar për larjen e shpeshtë të duarve, si pjesë e rutinës së përditshme të fëmijëve, veçanërisht të fëmijëve të vegjël, dhe ofroni mjaftueshëm sapun ose dezinfektantë me bazë alkooli dhe ujë të pastër në hyrjen dhe në të gjitha mjediset të parashkollorit. Mbani parasysht vendosjen e posterave pamorë në klasa, në mënyrë që të shihen dhe të kujtohen nga fëmijët dhe stafi.
- Mundësoni qarkullimin e ajrit dhe ventilimin nëpër klasa nëse e lejon moti.
- Sigurohuni që plehurat hidhen çdo ditë, në mënyrë të duhur.

Siguria dhe higjiena në lidhje me përgatitjen dhe administrimin e vakteve të parashkollorit^{viii}

- Mundësoni përputhshmërinë me legjislacionin kombëtar mbi sigurinë ushqimore dhe parimet e higjienës dhe sigurisë ushqimore të përshtatshme, që zbatohen nga furnitorët e ushqimeve gjatë blerjes, dërgimit, ruajtjes, përgatitjes dhe shpërndarjes së vakteve.
- Vendosja e kujtesave pamorë mbi parimet higjienike të përgatitjes së ushqimit, duke përfshirë larjen dhe dezinfektimin e përditshëm të sipërfaqeve ku përgatitet ushqimi, kuzhinës, dhe hapësirave të ngrënies, krahas mjeteve dhe enëve të gatimit dhe të ngrënies.
- Sigurohuni që furnitorët e ushqimeve kanë akses në mjetet dhe materialet e pastrimit dhe dezinfektimit, dhe monitoroni përdorimin e tyre të përshtatshëm, duke përfshirë larjen e rregullt të duarve. Nëse është e përshtatshme, ofroni materiale parandaluese (maska dhe doreza).
- Siguroni marrjen e masave specifike për të mos lejuar përkohësisht punonjësit, që vuajnë nga një sëmundje infektive, që të hyjnë në hapësirat ku përgatitet ose prodhohet ushqimi. Ky hap vlen më shumë për rastet kur kanë simptoma ose temperaturë.
- Ndërprisni ushqimin me bufe, dhe ofroni racione ushqimore individuale, nëse është e mundur.
- Vaktet mund të ofrohen në sallën e ngrënies ose në salla të tjera me hapësirë më të madhe, si: palestra, biblioteka ose hapësira të tjera të përbashkëta. Përpiquni të ruani sa më shumë distancë midis fëmijëve, duke marrë parasysht numrin e tyre dhe përmasat e sallës së ngrënies. Krahas kësaj, vaktet mund të organizohen në sallën ku qëndrojnë fëmijët, në mënyrë që ushqimi të ndahet paraprakisht në racione.
- Merrni parasysht distancën e sigurt midis fëmijëve ndërkohë që presin në radhë për të marrë ushqimin, dhe kurdo të jetë e mundur, planifikoni që të njëjtit fëmijë të hanë së bashku.
- Minimizoni rreziqet e kontaminimit. Kujtoju fëmijëve që të mos ndajnë dhe të mos prekin ushqimin ose pijet me persona të tjerë, si dhe kërkoni që mos të përdorin enët apo të konsumojnë ushqimet e njëri-tjetrit, etj.
- Mos i lejoni personat e tjerë (persona që pastrojnë, riparojnë, ose sjellin ushqimin) që të hyjnë në hapësirën e ngrënies gjatë kohës që fëmijët janë brenda.

Menaxhimi i një fëmije ose punonjësi të sëmurë

- Informojeni stafin se sa rëndësi ka të jenë vigjilentë mbi simptomat dhe kontaktin me menaxherët e godinës nëse ose kur të fillojnë të ndihen keq.

- Gjatë ardhjes dhe largimit nga puna çdo ditë, rekomandohet matja e temperaturës së të gjithë punonjësve me një termometër pa kontakt, si dhe konfirmimi i faktit nëse vuajnë nga simptoma respiratore ose shenja të sëmundjeve të tjera.
- Punonjësit, të cilëve u është rritur temperatura e trupit, të cilët kanë simptoma respiratore ose shenja të sëmundjeve infektive, nuk duhet të vijnë në punë, të kujdesen për fëmijët, ose të vijnë në mjediset e institucionit.
- Niveli drejtues i parashkollorit duhet të planifikojë një skemë zëvendësimi për stafin që aktivizohet në rast sëmundjesh
- Caktoni procedura për të garantuar që fëmijët dhe stafi, të cilët vijnë të sëmurë ose sëmurën në parashkollor, dërgohen në shtëpi sa më shpejt të jetë e mundur.
- Mbajini fëmijët ose punonjësit e sëmurë larg fëmijëve dhe punonjësve të shëndetshëm derisa të dërgohen në shtëpi. Në këtë rast ndiqni udhëzimet kombëtare të përshtatshme.
- Merrni parasysh nevojën për mbajtjen e emrave të fëmijëve që kanë pasur temperaturë të lartë dhe kanë shfaqur simptoma të tjera në parashkollor, për të gjurmuar kontaktet në rast se konfirmohet COVID-19.

MASAT E SUGJERUARA PËR GARANTIMIN E MIRËQENIES DHE ZHVILLIMIT TË FËMIJËS

Distancimi fizik në parashkollor

- Vlerësoni se çfarë mund të bëni për të kufizuar kontaktin fizik të drejtpërdrejtë midis fëmijëve, duke mos harruar parimet zhvillimore dhe faktin se është natyra e fëmijëve të vegjël që të tregojnë afërsi fizike dhe sociale.
 - Konsideroni hapjen e parashkollorit me turne, në mënyrë që të kufizoni numrin e fëmijëve në grup. Gjysma e fëmijëve mund të vijnë paradite, ndërsa gjysma tjetër pasdite.
 - Nëse është e mundur, shqyrtoni shtimin e mësuesve, me qëllim uljen e numrit të fëmijëve në klasë (nëse e lejon hapësira).
 - Vlerësoni mundësinë e ruajtjes së distancës prej të paktën 1 metër^xmidis të gjithë personave në shkollë, duke përfshirë edhe distancën midis edukatorëve dhe fëmijëve, si dhe distancën midis vetë fëmijëve. Vlen të nënvizohet fakti se fëmijët e vegjël kërkojnë kujdes po aq sa kanë nevojë për të nxënë dhe edukuar. Në kontekstin e ofrimit të kujdesit (p.sh., ndihmoni një fëmijë të ndërrojnë rrobat, të ushqehet, ose ofrojuni ndihmë emocionale kur është në ankth) mund të mos jetë e mundur ose e këshillueshme që të ruani distancën fizike. Edukatorët dhe drejtuesit e parashkollorit duhet të jenë diskret dhe të respektojnë parimet zhvillimore kur bien dakord për ruajtjen e distancës së arsyeshme midis stafit dhe fëmijëve.
 - Diskutoni dhe mësojuni fëmijëve dhe stafit përshëndetjet pa kontakt fizik. Mbani parasysh që këto përgjigje duhet të jenë argëtuese dhe miqësore me fëmijët, si: përshëndetje në gjuhën e shenjave, shenja e paqes, tundja e dorës, shkelja e syrit, etj.
 - Shtoni hapësirën midis tavolinave, karrigeve, ose zonave ku ulen fëmijët në tapet.
-
- Planifikojini pushimet në mënyrë të tillë që fëmijët të luajnë në sheshin e lojërave ose në hapësirat e përbashkëta në grupe më të vogla.
 - Kufizoni përzierjen e klasave dhe grupeve të fëmijëve. Për shembull, fëmijët në një grup të vogël ose klasë të qëndrojnë në të njëjtin grup/klasë me të njëjtin mësues gjatë gjithë ditës, pa i përzierë me fëmijët dhe edukatorët nga grupet e tjera.
 - Nëse është e mundur, gjatë orarit të gjumit, sigurohuni që hapësirat (ose shtretërit) ku flenë fëmijët të jenë sa më larg të jetë e mundur, në varësi të hapësirës. Merrni parasysh vendosjen e fëmijëve në shtretër, ku koka e njërit të jetë përballë këmbëve të tjetrit, për të ulur rrezikun e mundshëm të përhapjes.

Planifikimi i të nxënimit

- Nëse e mundëson moti, mësimet dhe aktivitetet mund t'i zhvillohen në ambientet e jashtme. Fëmijët e vegjël kanë shumë dëshirë të luajnë jashtë, dhe aktualisht është më e sigurt që fëmijët të mësojnë në ambiente të jashtme sesa në të brendshme. Merrni parasysh përshtatjen e kurrikulës dhe mësimdhënies në mënyrë që t'i mundësoni në ambiente të jashtme. Në këtë rast, mund të përdorni pajisje të ndryshme dhe natyrën si materiale mësimdhënieje/mësimnxënieje (formoni një rreth në ambient të jashtëm, mësoni për natyrën, etj.), si dhe mund t'i përmirësoni përvojat e të nxënimit përmes aktiviteteve fizike jashtë (lojërat për aftësitë e motorikës së madhe, vallëzim, sporte, etj.).
- Ajrosini dhomat sa më shumë të jetë e mundur gjatë ditës, organizojeni hapësirën e të nxënimit në mënyrë të tillë që të respektohet distanca midis fëmijëve, por të ruhet edhe ndjesia e komunitetit. Për shembull, caktoni vendet për t'u ulur ose për të qëndruar në këmbë (përmes materialeve të ndryshme si ngjithës letër, rrathë, litar, etj.)
- Ndajini fëmijët në grupe më të vogla prej 2-3 pjesëtarësh për të mundësuar ndërveprimin midis tyre, por edhe për të kufizuar aktivitetet në grupe të mëdha.
- Përshtateni kurrikulën dhe përdorni praktika pedagogjike krijuese për të garantuar një përvojë argëtuese të nxënimit mbi situatën e pandemisë (p.sh. të nxënimit me bazë projektin mbështetur mbi përvojën e fëmijëve me pandeminë; përdorimi i lojërave imagjinare që t'i ndihmoni fëmijët të përballojnë stresin dhe të promovoni reziliencën; shfrytëzimi i çasteve të përshtatshme për t'iu mësuar fëmijëve mbi pandeminë dhe rolin e tyre në garantimin e shëndetit publik)
- Ekuilibroni aktivitetet e të nxënimit individual me ndërveprimin në grupe të vogla; tregohuni krijues për të kombinuar ndërveprimin individual dhe në grup (p.sh. reflektim/punë individuale, duke vijuar me shkëmbimin e tyre me bashkëmoshatarët)

Lodra, materiale, lojëra dhe rutina

- Lodrat dhe materialet që janë të vështira për t'u dezinfektuar ose për t'u pastruar duhet të hiqen, duke përfshirë edhe lodrat e buta. Megjithatë, shumë materiale dhe lojëra mund të vazhdojnë të përdoren nëse i udhëzoni fëmijët që t'i lajnë duart para dhe pas përdorimit të tyre. Udhëzoni fëmijët që të mos i fusin lodrat/materialet në gojë.
- Organizimi i hapësirave individuale për çdo fëmijë përmes lapustilave, gërshërëve, dhe bojërave të dhjemit, që mund të përdoren nga çdo fëmijë, është një mënyrë e mirë për të nxitur krijimtarinë dhe artin pa qenë nevoja që fëmijët t'i ndajnë me njëri-tjetrin.
- Përqendrohuni te lojërat imagjinare dhe fizike, që mund të respektojnë distancimin social, këndimin, projektet artistike individuale, etj.
- Lojërat dhe projektet ku çdo fëmijë mund të kontribuojë individualisht (një nga një) do të funksionojnë më së miri, dhe mund të përfshijnë krijimin e një historie si klasë, mbajtjen e radhës, ose krijimin e një pikturë në mur teksa fëmijët qëndrojnë në radhë, etj.
- Mbështetuni në leximin ndërveprues me zë të lartë dhe aktivitetet argëtuese me të gjithë klasën, si: teatër kukullash nga mësuesi, ose një këngë e re që mund ta mësojnë të gjithë.
- Njësoj si materialet e tjera të shtypura, si: posta ose zarfet, librat e fëmijëve nuk konsiderohen me rrezikshmëri të lartë transmetimi dhe nuk kërkojnë pastrim ose dezinfektim shtesë.
- Shmangni përzierjen e lodrave të klasave apo grupeve të ndryshme të fëmijëve përpara se t'i lani dhe/ose t'i dezinfektoni

MASAT E SUGJERUARA PËR GARANTIMIN E KOMUNIKIMIT DHE MBËSHTETJES PRINDËRORE

- Informojini prindërit për masat që po ndërmerr institucioni parashkollor dhe kërkon bashkëpunim për të raportuar rastet e COVID-19 në familje. Nëse dikush në familje dyshohet se është infektuar

me COVID-19, udhëzohet prindërit që ta mbajnë fëmijën në shtëpi dhe ta informojnë parashkollorin.

- Përforconi politikën e “qëndrimit në shtëpi nëse nuk ndjeheni mirë” për nxënësit, mësuesit dhe stafin shkollor që kanë simptoma. Nëse është e mundur, lidhuni me organizatat vendore për të ofruar mbështetje të kujdesit në shtëpi dhe për të siguruar komunikimin midis shtëpisë dhe parashkollorit. Informojini prindërit se sa rëndësi ka të matin rregullisht temperaturën e tyre dhe të fëmijëve, si dhe t’i mbajnë fëmijët në shtëpi nëse kanë temperaturë të lartë.
- Përgatitni procedura për mbërritjen dhe largimin nga parashkollori, të cilat nuk krijojnë panik te fëmijët dhe familjet, duke qenë se fëmijët tashmë kërkojnë siguri nga kujdestarët dhe mësuesit e tyre, pasi nuk e kanë frekuentuar parashkollorin për disa javë me radhë. Minimizoni stresin dhe traumën që mund të krijohet te fëmijët për shkak të kthimit në normalitet.
- Merrni parasysh rregullimin e orareve të mbërritjes dhe të largimit dhe/ose kërkojuni kujdestarëve të fëmijëve që të vijnë pranë godinës dhe t’i marrin fëmijët aty. Më e mira do të ishte që fëmija të merret dhe të silllet në parashkollor vetëm nga një prind/person. Këshilloni shmangien e grumbullimit të shumë personave gjatë marrjes së fëmijëve nga parashkollori ose kujdesi ditor, dhe nëse është e mundur, shmangni marrjen nga një familjar i moshuar ose anëtar i moshuar i komunitetit (gjyshërit).
- Hartoni një listë kontrolli që prindërit të vendosin nëse fëmijët e tyre mund të shkojnë në kopsht, duke marrë parasysh epidemiologjinë vendore të COVID-19. Lista e kontrollit duhet të përfshijë:
 - Gjendje dhe dobësi shëndetësore të tjera të fëmijës dhe/ose familjarëve; Sëmundjet ose simptomat e kohëve të fundit që tregojnë COVID-19; Rrethana të veçanta në mjedisin e shtëpisë, në mënyrë që të ofroni mbështetje të veçantë;
- Merrni parasysh vendosjen e posterave ose kujtesave pamore të dobishme për prindërit në ambientet e shkollës ose në zonën e mbërritjes/largimit.
- Forconi mekanizmat e komunikimit dhe koordinimit, që promovojnë dialogun dhe angazhimin e rregullt me fëmijët, për të zbutur stresin, ankthin, dhe për t’u siguruar fëmijëve vazhdimësinë nga shtëpia në shkollë. Mbështetini mësuesit dhe drejtuesit që t’iu dërgojnë vazhdimisht prindërve mesazhe pozitive.
- Kontaktoni rregullisht me familjen mbi mënyrën sesi ndihen fëmijët e tyre. Krijoni mekanizma referimi për familjet që kanë nevojë për mbështetje psikosociale.

MASAT E SUGJERUARA PËR TRAJNIMIN DHE MBËSHTETJEN E STAFIT

- Politikat duhet ta mbështetin stafin, mësuesit dhe nxënësit që janë në rrezik të lartë për shkak të moshës ose sëmundjeve të tjera nga të cilat vuajnë, duke ofruar plane për zëvendësimin e mësuesve që mungojnë dhe për të vazhduar mësimin në distance, me qëllim që të ndihmoni nxënësit të cilët nuk arrijnë të vijnë në shkollë, duke u treguar fleksibël me rrethanat individuale. Merrni parasysh politikat dhe praktikat fleksibël të largimit.
- Udhëzohet punonjësit mbi detyrimin për të monitoruar shëndetin e tyre dhe gjendjen e fëmijëve, si dhe për të respektuar procedurat në përputhje me rekomandimet mbi parandalimin e COVID-19 (duke përfshirë respektimin e distancimit social dhe përdorimin e pajisjeve të mbrojtjes personale). Trajnimi stafin administrativ dhe mësuesit mbi zbatimin e praktikave të sigurisë dhe higjienës, dhe shtoni numrin e stafit në parashkollor, nëse është e nevojshme. Stafi i pastrimit, stafi që përgatit ushqimin, etj., duhet të trajnohen mbi dezinfektimin dhe të ketë pajisje të mbrojtjes personale, nëse është e mundur.
- Mbështetini mësuesit në përshtatjen e efektshme të kurrikulës dhe rutinës ditore të fëmijëve, duke përfshirë rikonceptimin e aktiviteteve dhe lojërave me të gjithë klasën, zhvillimin e orëve mësimore në natyrë, etj.
- Përmirësoni kompetencat e mësuesve të parashkollorit për të mbështetur nevojat socio-emocionale të fëmijëve. Pajisini mësuesit me aftësitë e nevojshme për të trajtuar shëndetin mendor dhe nevojat psikosociale (MHPSS) të fëmijës. Ndihmohet mësuesit të kuptojnë se, njësoj

si të rriturit, shumica e fëmijëve janë të shqetësuar dhe të stresuar, ndaj ky tranzicion do të jetë i vështirë në fillim. Priten edhe sfida në sjelljen e tyre. Përpjekjet për trajnim duhet të përmirësojnë shprehimisht aftësinë e mësuesve për të përmbushur nevojat socio-emocionale bazë të fëmijëve, veçanërisht në kopsht ku ka një numër të lartë nxënësish në rrezik.

- Mësuesit duhet të trajnohen për të qenë në gjendje të identifikojnë ndryshimet njohëse dhe sjellore, dhe për të ofruar mbështetje të të nxënësve sipas moshës.
- Kontaktoni rregullisht me mësuesit dhe stafin dhe mbështetni shëndetin e tyre mendor dhe nevojat psikosociale.

PËRFUNDIME

Me rihapjen e parashkollorit pas pandemisë së COVID-19, sfida më e madhe për menaxherët e programeve, drejtorët, mësuesit, dhe familjet do të jetë bashkëpunimi *jo vetëm për ekuilibrimin, por edhe për përmbushjen* e nevojës për respektimin e udhëzimeve kombëtare të arsyeshme dhe të përshtatura të shëndetit publik, me krijimin e një mjedisi stimulues, argëtues dhe të sigurt, që promovon shëndetin fizik, sigurinë emocionale, lidhjet sociale, dhe të nxënësve ndërveprues të fëmijëve të vegjël. Bashkëpunimi dhe komunikimi gjithëpërfshirës dhe i hershëm midis të gjitha palëve të interesit do të jetë kyç për zbatimin e masave të nevojshme. Ka rëndësi ruajtja e fleksibilitetit dhe modifikimi i qasjeve, sipas nevojës, si dhe garantimi i të nxënësve dhe shkëmbimi i praktikave të mira^x.

Referenca dhe poshtëshënime:

ⁱKuadri për rihapjen e shkollave (*Framework for reopening schools*), prill 2020.

<https://www.unicef.org/media/68366/file/Framework-for-reopening-schools-2020.pdf>

ⁱⁱKuadri për rihapjen e shkollave (*Framework for reopening schools*), prill 2020.

<https://www.unicef.org/media/68366/file/Framework-for-reopening-schools-2020.pdf>

ⁱⁱⁱKonsiderata për masat e shëndetit publik lidhur me shkollën në kontekstin e COVID-19 (*Considerations for school-related public health measures in the context of COVID-19*), maj 2020. <https://www.who.int/publications-detail/considerations-for-school-related-public-health-measures-in-the-context-of-covid-19>

^{iv}Ndonëse parimet dhe masat e përshkruara në këtë udhëzim vlejné edhe për rihapjen e qendrave të kujdesit ditor dhe çerdheve për fëmijët 0-3 vjeç, për këta fëmijë në moshë më të vogël kërkohen masa dhe konsiderata shtesë, veçanërisht në drejtim të gjetjes së një ekuilibri midis distancimit fizik dhe kujdesit mëkues dhe mbështetjes.

^vPërshtatur nga *Konsideratat për masat e shëndetit publik lidhur me shkollën në kontekstin e COVID-19* (*Considerations for school-related public health measures in the context of COVID-19*), maj 2020.

<https://www.who.int/publications-detail/considerations-for-school-related-public-health-measures-in-the-context-of-covid-19>

^{vi}Masat e sugjeruara dhe të përshtatura nga “*Konsideratat për masat e shëndetit publik lidhur me shkollën në kontekstin e COVID-19*” (*Considerations for school-related public health measures in the context of COVID-19*), maj 2020. <https://www.who.int/publications-detail/considerations-for-school-related-public-health-measures-in-the-context-of-covid-19>

^{vii}OBSH-ja rekomandon 70% alkool etilik për të dezinfektuar sipërfaqet dhe pajisjet e vogla, ose 0.1% hipoklorit natriumi për dezinfektimin e sipërfaqeve.

^{viii}Ndonëse nuk ka gjasa që virusi të transmetohet nëpërmjet ushqimit, është kyçe që të garantohet përputhshmëria e furnitorëve të ushqimit dhe punonjësve me rekomandimet e sigurisë ushqimore bazë gjatë përgatitjes së vakteve. Kjo është e nevojshme edhe për të parandaluar sëmundje që vijnë nga ushqimi, që mund të ndërlikojnë më tej përgjigjen ndaj COVID-19 ose mund të dobësojnë sistemin imunitar të fëmijëve.

^{ix}Konsiderata për masat e shëndetit publik lidhur me shkollën në kontekstin e COVID-19 (*Considerations for school-related public health measures in the context of COVID-19*), maj 2020. <https://www.who.int/publications-detail/considerations-for-school-related-public-health-measures-in-the-context-of-covid-19>

^x Po aty

Falënderime

Ky dokument është hartuar në konsultim me zyrat vendore të rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore. Komentet nga kolegët në rajonet e tjera, zyra qendrore, dhe partnerët do të vazhdojnë ta forcojnë më tej.